



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.221/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.01.2025, merr këtë:

### **V E N D I M**

- I. Pranohen të bazuara ankesat e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, Anr.221/2025, dhe Anr.222/2025 të datës 27.01.2025.
- II. Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5.000.00, (pesëmijë) Euro.
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### **A r s y e t i m**

Me datën 27.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.221/2025 dhe Anr.222 nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendohet se më datë 26 Janar 2025, rreth orës 17:00, monitoruesit e organizatës së tyre, kanë vërejtur se në rrugën kryesore të fshatit Leshak, Komuna e Leposaviqit, gjegjësisht në ndërtesën e trafos elektrike të këtij fshati janë vendosur posterë të subjektit politik Lista Serbe. Sipas pretendimeve në ankesën Anr.222 monitoruesit e njëjtës organizatë më datë 27 janar rreth orës 15:00 kanë vërejtur se në rrugën kryesore të fshatit Soçanicë, komuna e Leposaviqit, gjegjësisht në ndërtesën e Trafos elektrike të këtij fshati është vendosur posterë të subjektit politik Lista Serbe.

Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si provë për pretendimet në ankesë, parashtruesi ka bashkangjitur fotografën e posterit të subjektit politik Lista Serbe e vendosur në trafon elektrike tek rruga kryesore e fshatit.

Më datë 28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për ankesat e paraqitura kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik Lista Serbe, theksojnë se i kanë shqyrtuar provat që keni dërguar në ankesë dhe kanë konstatuar se, për fat të keq, pretendimet në ankesë janë të sakta, edhe pse koha e saktë e kryerjes së veprës nuk është e specifikuar. Në vazhdim të përgjigjes theksojnë se në ankesën Anr.221/2025, përmes një hetimi të detajuar kanë konstatuar se fjala është për të njëjtin objekt, dhe se aktivistë të rinj dhe pa përvojë të subjektit politik dëshironin të ngjiten sa më shumë materiale zgjedhore, ishin të pakujdesshëm, sepse ky është cikli i tyre i parë zgjedhor, bëhet fjalë për të rinjtë e subjektit të tyre politik, që nuk kishin dijeni se varja e posterave në hapësira publike është një aktivitet i paligjshëm. Më tutje në përgjigjen e tyre njoftuan se menjëherë i kanë urdhëruar që të korrigojnë gabimin e tyre dhe të heqin posterat e vendosur në hapësirat publike, ku shihet nga fotografitë të bashkangjitura, të cilët PZAP mund ti krahasojë me fotografitë nga ankesa e KDI-se për të njëjtin trafo stacion nga ankesa e parashtruar Anr.222/2025.

Kërkojnë që të merren parasysh argumentet e tyre dhe njëri nga ankesat të hedhet poshtë sepse ka të bëjë me rastin e gjykuar për të njëjtën çështje duke propozuar që bazuar në të gjitha sa më sipër dhe në përputhje me nenin 118 të ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës propozojnë që PZAP të miratojë përgjigjen ndaj ankesës si të bazuar, dhe të hedhe poshtë ankesën sepse është duplikim i ankesës së parashtruar më herët, që PZAP të vendos gjobën sa më të butë të parashikuar me ligj.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.221/2025, dhe A.nr.222/2025 të paraqitura me datë 27.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.221/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga organizata e njëjtë kundër subjektit të njëjtë politik Lista Serbe, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, dhe përgjigjes në ankesë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik Lista Serbe, në ndërtesën e trafos elektrike në fshatin Leshak të Leposaviqit dhe janë vendosur posterë të subjektit politik Lista Serbe si dhe rrugën kryesore të fshatit Soçanicë, komuna e Leposaviqit, gjegjësisht në ndërtesën e Trafos elektrike, kanë shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore hapësirat publike konkretisht në objektet dhe në hapësirat/rrugët publike. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në*

*apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00)euro.

Paneli shqyrtoi edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lista Serbe në të cilën thekson se nga provat e ofruar pretendimet për fat të keq janë të sakta por vetë koha e saktë e veprës nuk është specifikuar dhe ku thekson se kanë ndërmarr masa permisuese dhe kanë larguar posterat, për Panelin këto pretendime janë të pabazuara dhe të pa argumentuara për faktin se nga përgjigja e ofruar nuk ka arritur që ti vërtetoj me asnjë provë dhe dëshmi konkrete thëniet e pretenduar në përgjigjen e saj, gjegjësisht se i kane larguar posterat nga vendet e kontestuara.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, që konsiston në faktin se subjekti politik Lista Serbe, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës. Pretendimi i subjektit politik Lista Serbe në përgjigjen në ankesë se janë larguar banerët/posterët e vendosur, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në përgjigjen në ankesë, nuk është bashkangjitur asnjë prove qe dëshmon pretendimet e tilla. Sa i përket lartësisë së dënimit, paneli pati parasysh faktin se subjekti politik Lista Serbe është përsëritës i shkeljeve të theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.221/2025 datë 30.01.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së